KOLEGJI UNIVERSUM

**MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË**

midis

**Kolegjit ''UNIVERSUM''- Prishtinë**

**dhe**

**Spitali BAHCECI**

## I. Qëllimi i Memorandumit

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellët, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas.

## II. Fusheveprimtaria

1. Me anë të këtij memorandumi, Kolegji Universum merr përsipër ofrimin e bursave të pjesshme akademike për punonjësit e organizatës së lartpërmendur.
2. Bursat ofrohen për nivelin Baqelor dhe Master, dhe janë të aplikueshme për të gjitha programet e akredituara të Kolegjit Universum.
3. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit Spitali Bahceci do ti mundësojë studentëve të Kolegjit Universum përfundimin e internshipit/punës praktike me kohëzgjatje të dakorduar në mes të Kolegjit Universum dhe organizatës së lartpërmendur.
4. Me anë të këtij memorandumi të mirëkuptimit, palët dakordohen që të bëjnë shkëmbimin e stafit **(në raste të caktuara)** për pjesëmarrje në ligjërata publike apo evenimente të organizuara në frymën profesionale.

## III. Përzgjedhja e Kandidatëve për Bursa

Përzgjedhja e përfituesve të bursave do të bëhet nga Spitali Bahceci duke respektuar kriteret e përgjithshme. Përvoja paraprake dhe mundësia e kandidatëve për tu ngritur në karrierë duhet të merren parasysh gjatë procesit të përzgjedhjes. Preferohet që përzgjedhja e kandidatëve të mos koncentrohet

në një departament apo nivel të menaxhmentit. Preferohet që të ketë diversitet (gjinor, etnik, fetar dhe social) gjatë përzgjedhjes së kandidatëve.

**IV. Përzgjedhja e Kandidatëve për Internship/Punë Praktike**

1. Përzgjedhja e Kandidatëve për Internship/Punë Praktike do të bëhet nga Kolegji Universum duke marrë parasysh nevojat dhe konkurset e Spitalit Bahceci.

2. Kolegji Universum do të sigurojë që kandidatët e përzgjedhur të jenë të nivelit të kënaqshëm dhe të kenë potencial për avancim në karrierën e tyre profesionale.

**V. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni**

**I.** Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuara sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuar me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjërës palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër;

**II.** Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellët me besueshmëri të plotë;

**VI.** Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.

**VII.** Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, përpos nëse parashihet ndryshe me marrëveshje nga ana e palëve të përfshira në memorandum.

Prishtinë, më /Maj/2017

**PALËT NËNSHKRUESE**

**Kolegji ''UNIVERSUM''**
Alejtin Berisha
Drejtor Ekzekutiv

KOLEGJI UNIVERSUM * UNIVERSUM * PRISHTINË

Përfaqësuar nga:

bahceci Spitali Special Bahceci Healthcare SH.P.K.